

Specifikime

Teknike

Paraqitje

Ky specifikim teknik eshte document kontraktor eshte hartuar nga studio projektuese enkas per objektin : “Sistemim, asfaltim, ndërtimi i korsisë së bicikletave dhe ndricim i rrugës hyrëse të qytetit, Loti 1 segmenti Elbasan - Peqin dhe unazës së qytetit” ne Peqin.

Zerat e rradhitur ne kete specifikim, perkojne me zerat e preventivuar, mbeshtetur ne projektin e hartuar dhe ne “Manualet teknike te cmimeve te ndertimit dhe analizat teknike te tyre” te miratuar nga K.M i Republikes se Shqiperise me vendimin nr 629 date 15.7.2015.

Standartet e cilesise se materialeve te perdorura jane , ato te shtetit Shqiptar per materialet prodhim vendi dhe ato te vendeve te Bashkimit Europian per materialet e importit. Ne keto raste Administratori i kontrates vec certifikates se origjines mund te kerkoje dhe certifikat e cilesise dhe te dhenat per performancen teknike te artikujve qe do te furnizohen.


Standartet e perdorura ne kete specifikim teknik , nuk jane mbeshtetur vetem ne vizatimet e projektit , kushtet teknike te projektimit dhe te zbatimit ,por edhe ne manualet ligjore dhe ne libra te tjere.

*Keto specifikime teknike, theksuam qe jane hartuar enkas per“**Rikualifikimi i rruges hyrse per ne Peqin nga Elbasani**” ne Peqin dhe nuk mund te perdoren per objekte te tjera.*

Subjeketi i perfshire ne hartimin e ketij rikonstruksioni, ne rast problemi, mund te beje sugjerime, permiresime dhe plotesime te ketyre specifikimeve, ne se kerkohet nga ndryshime te mundshme te kategorive te punimeve ose mungesa e detajeve dhe e materialeve.

TE PERGJITHESHME

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates dhe i sherbejne kontraktorit per fazen e pergatitjes se ofertes dhe supervizorit gjate fazes se zbatimit.



“Rikualifikimi i rruges hyrse per ne Peqin nga Elbasani” perfshin punimet nga pika hyrse per ne qytetin e Peqinit nga Elbasani deri ne dalje te qytetit nga ana e Rogozhines. Nga hyrja deri ne distancen 1932 m qe perkon me pjesen e rruges ne hyrje te qytetit ku jane ndertuar trotuaret, eshte parashikuar te ndertohet nje korsi biciklete dhe brez gjalberimi, rikonstruksioni i urave dhe tombinove, ndertimi i jureve mbajtes ne zonat ku duhen , ndricimi me element foto voltaic dhe sinjalistika. Pwur pjesen nga ku jane ndertuar trotuaret deri te ura ne hyrje te qytetit me distance 325 m jane parashikuar plotesimi i trotuareve, sistemimi dhe plotesimi i pusetave te kontrollit qe ndodhen ne trotuare dhe pusetave te shiit ne rruge. Eshte parashikuar ndricimi dhe sinjalistika. Per rrugen qe kalon ne qytet eshte parashikuar qe ne nje ate te kete trotuar dhe piste bicikletash pa brez gjelberimi, ndersa ne karhun trjeter parashikohet nje shetitore ku e lejojne kushtet dhe trotuare ne zonat ku nuk ka kushte per shetitore, Eshte parashikuar sistemimi i pusetave te kontrollit ne rruge. Per pusetat e shiut eshte parashikuar te sitemohen ekzistueset dhe te ndertohen te reja. Eshte parashikuar ndricimi me element foto voltaic dhe sinjalistika e nevojshme Ne shetitore dhe trotuar eshte parashikur te vendoset nje pllake ne veshdim me relief ne sherbim te personave me afesi te kufizuara. foto dhe plotesimi i hyrje te qytetit ku aktualisht jane ndertuar trotuare eshte parashikuar te ndertohet ne nje kahe nje korsi biciukletash dhe brez gjelberimi, Pjke Peqin dhe nuk

Kontraktori dhe supervizioni duhet te kene parasysh qe :

1. Zevendesimi i materialeve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behet vetem me aprovimin e Supervizorit ne se materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materialet e specifikuara ; ose ne se materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates, per shkak te kushteve jashte kontrollit te Kontraktorit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument- deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materialeve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

2. Kontraktori do te verifikoje te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket,ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Moszbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Kontraktorin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme .Kontraktori do te marre persiper te gjitha pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive , llojeve dhe sasive te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

3. Kontraktori nuk do të behet asnjë pagesë mbi çmimet njësi të kuotuar për kostot e mobilizimit d.m.th. për sigurimin e transportit, dritë, energji, veglat dhe pajisjet, ose për furnizimin e godinës dhe mirëmbajtjen e impjanteve të ndërtimit, rrugëve të hyrjes, të komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punën, furnizimin me ujë, mbrojtjen kundër zjarrit, bangot e punës, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura të tjera të perkoheshme, pajisje dhe materiale, ose për kujdesin mjekësor dhe mbrojtjen e shëndetit, ose për patrullat dhe rojet, ose për ndonjë shërbim tjetër, lehtësi, gjëra, ose materiale të nevojshme ose që kerkohen për zbatimin e punimeve në përputhje me ato që është parashikuar në Kontratë.

4. Kontraktori të organizojë punën për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe me pas të spostoje dhe ta rivendosë çdo rrugë hyrje që do të duhet në lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do të përfshijë përshatjen e zonës me çdo rrugë hyrje dhe se paku me shkallë sigurie, qëndrueshmëri dhe të kullimit të ujërave sipërfaqësore të njejtë me ato që ekzistonte përpara se Kontraktori të hynte në Shesh.

5. Kontraktori ujin që nevojitet për zbatimin e punimeve do të merret nga rrjeti kryesor nëpërmjet një matësi në pikën me të afërt të mundshme. Kontraktori do të shtrijë rrjetin e vet të perkoheshëm të tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot për këto do të pagohen nga Kontraktori. Në rastet kur nuk ka mundësi lidhje me rrjetin kryesor, Kontraktori duhet të bëjë vetë përpjekjet për furnizimin me ujë higjienikisht të pastër dhe të pijshëm për punëtorët dhe punimet.

6. Kontraktori do të bëjë përpjekjet dhe me shpenzimet e tij për furnizimin me energji elektrike në kantier, si me kontraktim me KESH – in, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal janë të mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet për të përmbushur kërkesat.

7. Kontraktori, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave sic kerkohet, në përputhje me informacionin bazë të Punedhënesit, dhe do të jete përgjegjës i vetëm për përpikmerinë. Kontraktori do të jete përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohe do të jete subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhënesi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korigjimet e gabimeve ose të mangësive. Kontraktori do të furnizojë dhe mirëmbaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nëpërmjet një stafi të kualifikuar sic mund të kerkohet nga Punedhënesi për kontrollin e modinave dhe piketave.

8. Kontraktori do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave.

Perpara cdo aktiviteti ndertimor, Kontraktori do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve. Çdo pune e bere jasht akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Kontraktori do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Supervizorit.

9. Kontraktori duhet te beje forografi me ngjyra sips udhezimeve te Supervizorit ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit , progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Kontraktorit.

10. Kontraktori duhet te kete vecanerisht kujdes ne:


a) Nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone gjate periudhes se ndertimit.

b) Nrezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna.

E gjithë puna do te behet ne nje menyre te tille qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjeter dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjeter.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes Kontraktori gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te koeporoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun. Nga Punedhenesi rekomandohet qe punetoret e pakualifikuar te merren nga zona.

11. Kontraktori do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.



12. Kontraktori, gjate zbatimit te punimeve me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Kontraktori duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

13. Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Supervizori, mund te çojë ne nderprerjen e kontrates.

14. Kontraktori transportin e cdo materiali nga kavot, nyjet apo magazinat e ndryshme, do ta beje me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithë ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet ,duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion per tu kontrolluar nga Supervizori ne çdo kohe.

15. Kontraktori duhet te beje me shpenzimet e tij, te marre me qira ose te blerje nje terren te mjaftueshem per ngritjen e magazinave dhe zyrave te tij dhe per krijimin e nje zyre per Supervizorin siç eshte specifikuar, te gjitha keto me shpenzimet e tij.

16. Kontraktori duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet "sic jane faktikisht zbatuar" ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Kontraktori do te ruaje te gjithë informacionin e nevojshem per pergatitjen e "Vizatimt sic eshte zbatuar". Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Supervizorin. Keto vizatime do te azhornohen ne menyre te vazhdueshme dhe do ti dorezohen Supervizorit çdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithë konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Kontraktori, gjithashtu duhet te pergatise seksionet e profilit gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit.

Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “ sic eshte zbatuar” do t'i dorezohen Supervizorit per aprovim. Vizatimet “sic eshte zbatuar” ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhesisit.

Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “sic eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Kontraktorit.

Vizatimet duhet te printohen ne format A0, A1, A2, A3 dhe t'i dorezohen Investitorit ne 3 kopje.

17. *Kontraktori ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme te cdo lloji dhe te lere sheshin e tere dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Supervizori.*

PUNIME PER RIVESHJEN E RRUGES EKZISTUESE DHE NDERTIMIN E RRUGE VE ME TRASE TE RE

Skarifikim bari me lopate per bankinen dhe skarifikim shtrese asfalti me makineri perfshin:

Cmimi per njesi perfshin tere operacionet e punes duke filluar nga percaktimi I zones qe parashikon projekti te pastrohet dhe skarifikohet, nga bimesia dhe shtresa e asfalto betonit ekzistues me mjete mekanike dhe motorike te specializuara.

Nga bimesia skarifikohen zonat ku ndertohen trasete e reja te rruges dhe bankinat anash tyre, dhe perfshin prerjen apo shkuljen , grumbullimin , ngarkimin ne mjetin e transportit dhe cuarjen e tyre ne vendin e caktuar nga Bashkia .

Skarifikimi I shtreses se asfaltobetonit ekzistues se rruges qe do te rivishet perfshin:

Gryerjen e saj me makineri ne trashesine minimale 2 cm, grumbullimin e materialit qe del nga skarifikimi I cili lejohet te riciklohet per binder ne preset ku traseja e rruges behet e re.

Cmimi per njesi perfshin tere operacionet e punes qe parashikon nga gryerja deri ne magazinim apo largim te mbeturinave dhe garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Germimi ne rruge ,ura,mure e kudo tjeter perfshin :

Gërmim dheu per trasene e rruges ose per punime nentokesore, deri në thellesine 1,5 m nga rrafshi i tokes, ne truall te çfarëdo natyre dhe konsistence, te thare ose te

lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trugjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m³, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj., Përforcimin e çfarëdo marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve që mbeten bosh pas realizimit te themeleve me materialin e Gërmimit te kryer me krah, si dhe spostimin brenda ambientit te kantierit.

Gërmim me seksion te caktuar, per themele me thellesi deri në 1.5 m nga rrafshi i tokes, ne terren te çfarëdolloj natyre dhe konsistence, te lagur ose te thate (argjile edhe n.q.s. eshte e ngjeshur, rërë, zhavorr, gure etj..) duke perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trugjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m³, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj., Përforcimin e çfarëdolloj marke dhe rezistence.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Transport mbetje ndertimi, dheu me auto deri 5.0 perfshin :

Nngarkimin ne mjet te materialet e nxjera nga germimi i dherave ne trasene e rruges dhe kudo tjeter , dhe dergimin ne vendin e caktuar nga Bashkia, pa ndotur mjedisin e kantierit dhe rrugen per ne vendin e caktuar nga Bashkia.

Germim i shtreses asfaltike deri ne thellesine 10 cm pasi do te ribehet dhe shtresa e binderit me trashesi 6 cm, perfshihet prerje me disk diamanti perfshin :

Percaktimin dhe miratimin ,me shkrim ka supervizori I pjeses se demtuar dhe qe do te hiqet per rtu rriparruar.

Prerjen me disk diamante I tere perimetrit te pjeses se demtuar.

Germimin me tere menytrat e mundshme ne varesi te siperfaqes se demtuar qe do te germohet.

Largimi I tere mbeturinave te germimit nga zona e germuar dhe pastrami perfundomtar nga teret mbeturinat dhe pluhurat ne monemtin qe do te behet shtresa e binderit.

Shkulja e bordurave anesore te rruges brenda qytetit perfshin :

Shkuljen e tyre me krahe apo makineri, sipas mundesive qe lejon vendi ,

Perzgjedhja e bordurave qe mund te riperdoren pasi te jete bere miratimi me shkrim nga supervizori dhe investitori, duke bere reflektimet perkatese dhe ne situacion,

Dorezimin ne magazinat e investitori te bordurave te tjera ne se kerkohet me shkrim nje gje e tille nga supervizori dhe investitori.

Sperkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m² perfshin :

Pastrimin perfundimtar te siperfaqesqe do te sperkatet me bitun pak kohe para kryerjes se procesit, menjanimin e sperkatjes ne zona me prani lageshtie.

Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm dhe 20 cm , perhapur e ngjeshur makineri perfshin :

Te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me vleren e blerjes materialeve per ndertimin e shtreses uniforme me trashesine e projektit, punetoria, furnizimi, transporti, depozitimi dhe shtrimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrimi me 5 - 6 kalime vajtje ardhje deri ne ngjeshje 98%. Stabilizanti duhet te jete gur i thyer kavoje (mali) me granulometri 5/31.5 mm, ose ne rast te perdorimit te materialit vendor (cakull natyror) duhet paraprakisht te behen provat e materialit, te lajmerohet Investitori-Supervizori me shkrim dhe te merret Miratimi sipas perkatesise duke plotesuar kushtet teknike te zbatimit.

Mbushja me cakull do te filloje vetem pasi te jete perfunduar skarifikimi dhe pastrami I trupit te rruges dhe vetem pasi te jepet leje me shkrim nga supervizioni. Materiali mbushes duhet te jete nga kavot e miratuara nga investitori para se te filloje procesi. Para se te shtrohet satbilizanti duhet te behen pergatitjet topografike per niveleten e trasese duke vendosur piketa te qarta dhe te shpeshta. Materiali I transportuar nga kavot e miratuara do te shperndahen me grejder I cili net e njejten kohe siguron dhe nivelimin. Vetem pasi te jete bere nivelimi me grajder mund te filloje dhe te behet ngjeshja me vibro rul I cili sic thame me larte duhet te siguroje nje ngjeshje deri ne masen 98%. Vibrimi do te behet deri sa cakulli te ngjshet plotesisht.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtrese stabilizant me trashesi 15 cm perfshin :

Te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me blerjen se materialit, furnizimin, transportin, shperndarjen dhe rulimin e stabilizantit ne nje shtrese me trashesi 15 cm. Ky operacion pune mund dhe duhet te filloje vetem pasi te jene plotesuar detyrat e parashikuara ne piken 4 .Pas shperndarjes, stabilizanti duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt.

Shtrimine sshtrese se stabilizantit, pasi te jete perfunduar mbushja me material shkembor dhe te jete niveluar e ngjeshuar ai dhe vetem pasi te jete dhene leje me shkrim per fillimin e shtreses se stabilizantit mund te filloje trasportimi I materialit per ne trasesne e rruges. Para fillimit te punes duhet te behen pergatitjet topografike duke ngulur piketa hekuri dhe duke vene shenhat perkatese per kuotat kujdes dihet te tregohet per prerjen e stabilizantit dhe asfaltit ne zonen e kontaktit te shtresave.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri perfshin:

Te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me blerjen se materialit, furnizimin, transportin, shperndarjen dhe rulimin e binderit ne nje shtrese me trashesi 6 cm. Ky operacion pune mund dhe duhet te filloje vetem pasi te jete bere sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e binderit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine uniforme minimale te percaktuar ne projekt. Binderit ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Per pergatitjen e nje toni binderi duhet 55 liter bitum. Pas shperndarjes, binderi duhet te ruhet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat si dhe pastrimi i mbetjeve te asfaltobetonit mbi kuneten e betonit per te realizuar nje vije te dukshme. Ne kete cmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion.

Anet e shtreses se asfaltobetonit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa.

Ne kete cmim perfshihen dhe te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me blerjen emulsionit , furnizimin, transportin, shtrimin e shtreses per sperkatjen me emulsion te shtresave te rruges. Realizimi i kesaj shtrese do te aplikohet perpara aplikimit te shtreses se binderit.

Shtresa e binderit mund te filloje, pasi te jet perfunduar shtrimi nivelimi dhe rulimi I shtreses se stabilizantit dhe vetem pasi te jete dhene leje me shkrim per fillimin e shtreses se binderit mund te filloje transportimi I binderit per ne trasesne e rruges. Para fillimit te punes duhet te behen pergatitjet topografike duke ngulur piketa hekuri dhe duke vene shenjat perkatese per kuotat. Eshte mire qe shtrimi I binderit te behet me makineri qe e kapin tere gjeresine e rruges me nje here cka do te siguronte nje nivelim te garantuar. Ne se do te behet me makineri me koso te vogel kujdes duhet te tregohet per prerjen e stabilizantit dhe asfaltit ne zonen e kontaktit te shtresave.

Binderi dhe asfalti do te merren nga nje te perqendruara dhe qe sigurojne vazhdimesi pune. Lejohet qe keto punime te kryhen dhe me nenkontraktore por me pare do te lidhet kontrate me ta per detyrimet qe ka punemarresi ndej punedhenesit. Punimet duhet te kryhen me masa te plota mbrojtese ne pune dhe me perdorim te shenjave dalluese dhe mbrojtese. Kujdes do te behet me manaxhimin e trafikut per rastet kur punime do te vashdoje pa nderprerje te trafikut public.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri ne trasete e reja perfshin :

Te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me blerjen se materialit, furnizimin, transportin, shperndarjen dhe rulimin e asfalto betonit ne nje shtrese me trashesi 4

cm. Ky operacion pune mund dhe duhet te filloje vetem pasi te jene plotesuar detyrat e parashikuara ne piken 6 pasi te jete bere sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e asfalto betonit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine uniforme minimale te percaktuar ne projekt Asfalto betoni ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Per pergatitjen e nje toni binderi duhet 55 liter bitum. Pas shperndarjes, binderi duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat si dhe pastrimi i mbetjeve te asfaltobetonit mbi kuneten e betonit per te realizuar nje vije te dukshme. Ne kete cmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion.

Anet e shtreses se asfaltobetonit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa.

Ne kete cmim perfshihen dhe te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me blerjen emulsionit , furnizimin, transportin, shtrimin e shtreses per sperkatjen me emulsion te shtresave te rruges. Realizimi i kesaj shtrese do te aplikohet perpara aplikimit te shtreses se binderit.


Asfalto betony mund te filloje pasi te jet perfunduar shtrimi nivelimi dhe rulimi I shtreses se stabilizantit dhe vetem pasi te jete dhene leje me shkrimper fillimin e shtreses se binderit mund te filloje trasportimi I binderit per ne trasesne e rruges. Para fillimit te punes duhet te behen pergatitjet topografike duke ngulur piketa hekuri dhe duke vene shenhat perkatese per kuotat. Eshte mire qe shtrimi I binderit te behet me makineri qe e kapin tere gjeresine e rruges me nje here cka do te siguronte nje nivelim te garantuar. Ne se do te behet me makineri me koso te vogel kujdes dihet te tregohet per prerjen e stabilizantit dhe asfaltit ne zonen e kontaktit te shtresave.

Aasfalti do te merren nga nyje te perqendruara dhe qe sigurojne vazhdimesi pune. Lejohet qe keto punime te kryhen dhe me nenkontratore por me pare do te lidhet kontrate me ta per detyrimet qe ka punemarresi ndej punedhenesit. Punimet duhet te kryhen me masa te plota mbrojtese ne pune dhe me perdorim te shenjave dalluese dhe mbrojtese. Kujdes do te behet me manaxhimin e trafikut per rastet kur puno do te vashdoje pa nderprerje te trafikut

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 5 cm, me makineri ne riveshje perfshin :

Te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me blerjen se materialit, furnizimin, transportin, shperndarjen dhe rulimin e asfalto betonit ne nje shtrese me trashesi 4 cm. Ky operacion pune mund dhe duhet te filloje vetem pasi te jene plotesuar detyrat e parashikuara ne piken 6 pasi te jete bere sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e asfalto betonit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine uniforme minimale te percaktuar ne projekt Asfalto betoni ne



objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Per pergatitjen e nje toni binderi duhet 55 liter bitum. Pas shperndarjes, binderi duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat si dhe pastrimi i mbetjeve te asfaltobetonit mbi kuneten e betonit per te realizuar nje vije te dukshme. Ne kete cmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion.

Anet e shtreses se asfaltobetonit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa.

Ne kete cmim perfshihen dhe te gjitha shpenzimet qe kane te bejne me blerjen emulsionit , furnizimin, transportin, shtrimin e shtreses per sperkatjen me emulsion te shtresave te rruges. Realizimi i kesaj shtrese do te aplikohet perpara aplikimit te shtreses se binderit.

Asfalto betoni ne riveshje mund te filloje vetem pasi te kene perfunduar punimet per vendosjen e du bordurave anesore te rruges , pasi te kete perfunduar punimet per rruget me trase te re,dhe vetem pasi te kene perfunduar punime per urat ne trase dhe pasi te jete skarifikuar tere siperfaqia e rruges ekzistuese qe do te zhfrytezohet. Para fillimit te punes duhet te behen pergatitjet topografike duke ngulur piketa hekuri dhe duke vene shenhat perkatese per kuotat. Eshte mire qe shtrimi i asfalto betonit te behet me makineri qe e kapin tere gjeresine e rruges me nje here cka do te siguronte nje nivelim te garantuar. Ne se do te behet me makineri me koso te vogel kujdes duhet te tregohet per prerjen e stabilizantit dhe asfaltit ne zonen e kontaktit te shtresave. Trashesia e asfaltit eshte parashikur 5 cm per te mundesuar ndonje problem ne nivelete por eshte kusht qe kjo shtrese ne asnje menyre nuk duhet te dale me pak se 4 cm.

Asfalti do te merren nga nje te perqendruara dhe qe sigurojne vazhdimesi pune. Lejohet qe keto punime te kryhen dhe me nenkontratore por me pare do te lidhet kontrate me ta per detyrimet qe ka punemarresi ndej punedhenesit. Punimet duhet te kryhen me masa te plota mbrojtese ne pune dhe me perdorim te shenjave dalluese dhe mbrojtese. Kujdes do te behet me manaxhimin e trafikut per rastet kur puno do te vashdoje pa nderprerje te trafikut

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Ngritja deri ne kuoten e re te rruges I kapakut te pusetave te shiut perfshin :

Ne fillim do te percaktohet me numur pusetat qe do te plotesohen me kapak te rrij, te llogaritet pasha totale dhe te karahasonet me parashikimet ne preventive, analiza e cmimit per cdo pusete te ngitur parashikon 5 kg kappa gize. Per diferencat te behen veprimet perkatese me supervizorin dhe te merret miratimi I investitorit.

Pastrime e pusetes nga papasterite qe ndodhen ne te

Pershtatja e tyre me pusicionin e ri ne rap[ort me borduren e rruges e cila mund te kete opesuar spostim te vogel nga rikonstruksioni.

Fiksimin e kapakt egzistues apo te ri ne pozicionin e percaktuar ne project dhe te miratuar nga ssupervizori.

Ngritja deri ne kuoten e re te rruges I kapakut te pusetave te kontrollit qe ndodhen ne trupin e rruges brenda qytetit, perfshin :

Pastrimin e pusetes nga Brenda nga papastertite e mundshme, centrimin e kapakut ekzistues ne kuoten e projektit dhe lenjem anash te hapsires per asfalto beton, Ne analizen e cmimit eshte parasikuar qe rreth kapakut te gizes te vendoset derase 3 cm per te menjanuar gropen rreth pusetes.

Pusetat qe jane ne terotuar te rruges dhejane me kapk beton arme do te pershtaten si me siper dhe kapak jene parashikuar te rij gize.

Prishje mur guri e struktura betoni perfshin :

Prishjen e plote ose e pjesshme e muratures te gurit edhe n.q.s. eshte e suvatuuar, e cfaredo forme dhe trashesie, e kryer me cfaredolloj mjete dhe e cfaredo lartesie ose thellesie, perfshire skelen e sherbimit ose skelerine, armaturat e mundshme per te mbeshtetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat pereth, riparimi per demet te shkaktuara ndaj te treteve , si dhe cdo detyrim tjeter per ti dhene fund plotesisht prishjes .

Prishjen e totale ose e pjesshme e shtresave te betonit deri në trashesine 5 cm, duke përdorur çdo mjet, perfshire puntelimet, marrjen e masave per aplikimin e te gjitha akteve përkatëse te sigurise se mbrojtjes se punetoreve dhe popullsisë, sinjalet e dites e te nates si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve, punimet per rrethimet e perkohshme, riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve, duke perfshire ngarkimin e materialeve qe rezulton nga prishja dhe transportin per shkarkim.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prodhimi i paneleve beton arme te parafabrikuara per urat dhe Muret mbajtes me kunete I tipit M1 M2, me beton M 400, me permasat sipas projektit pefshin:

Prodhimin e tere ne fabrika apo kantiere te certifikuar te cilet garantojne betonin e M 400 dhe prodhimin e elementeve ne banko vibruese., prodhimi hiqet nga kallepi pas 24 oreve dhe pas qendrimit ne depozite minimum per 5 dite jane te gatshem te transportohen per ne sheshin e ndertimit.

Levizja e elementene nga kjalleper duhet te behet deturimisht nepermjet vinc urave dhe jo nepermjet vincave qe levizin me rrota apo zinxhire, Transportimi i elemeteve beton arme te parapergatitur nga fabrika per ne sheshoin e ndertimit duhet te behet me mjete telnollogjike dhe te pershtatshem. Rekomandohet q elementet te shkojne ne objekt vetem pasi te jene marre tere masat teniko dhe organizative qe elementet nga makine te vendosen ne vend pra te montohen

Elementet duhet te transportohen me mjete teknologjike dhe duhet te montohen direk nga makina, nuk perjashtohet dhe mundesia e depozitimit ne objekt por kostot shtese jane ne ngarkim te kontraktori

Njohjen e tregut te prodhimit te prodhimit te eelementeve te rende beton arme me marke shume te larte, qe mundeson heqjen e elementit brenda 24 oreve nga kallepet ku eshte prodhura dhe trasportimin e tyre per ne pisten e depozitimit. Fabrika apo kantieri i rprodhimit te elemnteve beton arme te parafabrikuar duhet te jhete e certifikuar dhe te kete teknologji dhe kushte qe garantojne qendrueshmeni dhe estetik per elementet qe prodhojne. Prodhimi duhet te behet me kontraktim, depozitimi i elementeve nuk lejohet me shume se 5 cope njeri mbi tjetri.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Prodhimi dhe hedhja ne veper e stiro beton perfshin :

Prodhimin e stiro betonit ne objekt me elektro apo motobetoniere, trasportimin , shperndarjen dhe ngjeshjen e tij ne objekt. Stito betoni eshte parashikuar per mbushjen e hapsires ndermjet dy bordorave te trotuarit , ne zonen ku urat zgjerohen, Eshte perzgjedhur ky lloj materiali per shkat te cilesive qe ka pasi siguron qendrueshmeni dhe ka peshet volumore me te ulet se betoni.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Punimet e hekurit te betonit perfshine :

Pergatitjen e shufrave te hekurit sipas kerkesave te projektit, per te gjithë elementet prej betoni te armuar ne kantjer, me hekur me karakteristika celik BST 500 ose Sidenor , ne dimensione dhe forma sipas elementeve te projektuara ne fletet përkatëse te projektit dhe sipas te gjitha kushteve teknike ne fuqi si normativat e kthimit te ganxhave, te zgjatimeve per hekurit me permasa te gjate etj..., per lende te pare (hekur) te shoqeruar me certifikatat e provave laboratorike per karakteristikat qe duhet te plotesoje, hekur pa perbajtje ndryshku duke perfshire çdo pune apo kerkesa tjeter per ta konsideruar punimin e hekurit te perfunduar ne menyre perfekte.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Detajet metalike qe futen ne beton perfshine :

Prodhimin e detajit ne repart te specializuar, me saldator te patentuar, rigorozisht sipas kerkesave te projwktit. Ganxhat qe futen me elementin parafabrikat dhe qe sherbejne per ngritjen e tij nga kallepi e depozitinin per ngarkim ne mjete dhe per

montim ne object duhet te prodhohen me hekut te bute duhet te prodhohen me kendin qe jep projekti per te shmangot ngjeshjet e saj dhe per te perjashtuar fenomenin e lodhjes. Detajet duhet te vendosen rigorosisht me percaktimet ne project sepse duhet te akopjohen ne fazen e montimit .

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Konstruksioni metalike per pareapete anesore perfshin :

Furnizim dhe vendosje në vepër parrmakut , te ndertuar nga: mbeshtetese me permasa sipas projektit cm te realizuara me profile te dyfishte te salduar ne menyre te rregullt dhe të vendosura ne nje largesi po sipas projektit cm, dhe të an salduar ne detajet metalike te paramontuar ne elementin beton arme. Parapeti mund te formohet dhe montohet ne project duke respektuar kerkesat e projektit.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Bojatisje konstruksione metalike, 1 minio + 1vaj, ne vaske parashikon:

Lyerje e elementeve prej hekuri, me boje te pergatitur me nje dore minio plumbi ose me antiruxho ne forme e vajit sintetik, me dozim per m² kg 0.080. Lyerja do te behet ne vaska ne repartee te specializuar dhe te licensuar,

Transportin e elementeve per ne kantier te mbrojtur nga demtimet.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.


Prodhim Mur mbajtes me kunete I tipit M2, ne fabrike te certifikuar me beton M 400

Struktura monolite betoni C 16/20 per mure mbajtes sipas profilit ne project perfshin :

Furnizimine betoneve nga fabrika apo nyje te certifikuara sipas receptura te miratuara per to ose me recepturat si me poshte ;

Beton marka 150 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 260 , rërë e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70, uje m³ 0,18.

Beton marka 200 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 300 , rërë e lare m³ 0,43 , granil m³ 0,69 , uje m³ 0,18 .



Beton marka 250 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 370 , rërë e lare m³ 0.43, granil m³ 0,69 , uje m³ 0,185 .

Beton marka 300 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm,rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 465 , rërë e lare m³ 0,38 , granil m³ 0,64 , uje m³ 0,195

Receptura e mesipermw do te vlejne per prodhimine betoneve ne object detyrimisht me elektro apo motobetoniera dhe te ngjeshut me vibrator.

Betonimi i mureve rekomendohet te behet ne tere lartesine e tij per te mundesuar faqe te paster port e hedhur e ngjeshur me shtresa.

Realizimin e kapucit te murit me permasat e parashikuara ne projekt, ne te gjithë gjerësine e muraturës poshte dhe lartësi prej 15 cm , i armuar ne menyre te rregullt. Vendosjen e tubove prej PVC je qe mundesojne percjelljen e ujit nga ana e brendsheme e murit ne anen e jashtme duke e leruar ate nga presiaone te b=ndryshme.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtresa e zhavorit parashikon:

Hedhjen dhe shtrimin e zhavori mbi terrenin e ngjeshur mire me perpara /ose mbi Shtresë kalldremi (sipas projektit), me zhavor lumi pa perberje argjilore dhe me lartësi te ndryshueshme sipas udhezimeve ne projekt, e ngjeshur dhe e rrafshuar mire, si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene fund punes.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtresa e betonit parashikon:

Shtresë betoni m-C12/15, sipas me lartësi te ndryshueshme sipas udhezimeve ne projekt, i hedhur në vepër mbi nje Shtresë zhavori dhe i formuar nga shtresa te vibruara mire, duke perfshire çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre te rregullt.

Garancite per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne process te kalimtareve dhe te komunitetit.

Shtresa e shetitores dhe trotuarit me pllaka beton te presuara parashikon:

Pllakat do te jene te dimensioneve sipas permasave forms dhe ngjyres se percaktuar ne project pasi korsi e bicikletave do te theksohet me diferencim ngjyre. Ngjyra e tyre do te percaktohet nga supervizori. Pllakat do te shrohen me llac te perzier, shtrimi do te filloje vetem pasi nivelimi I sipefaqes sipas kerkesave te

projektit te jete konfirmuar me process verbal. Nivelimi te behet nga nje specialist topograf me nje tolerance jo me shume se 5mm ne te gjithë godinen.

Bordurat

Bordurat kufizuese te rruges nga ted y anet jane me permasa 20 x35 cm ato do te montohen mbi nje shtrese betony C 7/10 te niveluar me instrument. Bordurat qe kufizojne shetitoren nga te dyanet jane me permasa 12x25 cm te montuara po mbi nje shtrese betony.

Bordurat e rruges nacionale 20x35 cm ngrihen mbi shtresen e asfaltit 15 cm, bresi I gjelbert realizohet 5 cm me poshte se bordure e rruges dhe bordure e trotuarit eshte 2 cm mbi kuoten e bresit te gjelbert

Sistemimi i tereneve te gjelberta, perfshin mbushjen me toke bujqesore, perpunimin me humus mbjelljen e barit dhe te pemeve.

Korsia e gjelberura anash rruges me gjeresi 40 cm e vendosur ndermjet dy bordurave asaj te rruges nacionale me permasat 20 x35 cm dhe asaj te shetitores me permasa 12 x25 cm. Formohen nga shtresa 20 cm me toke bujqeso + 5 cm humus pylli, e mbjelle me bar te pershtashem, 4 stinor. Kontraktori mund qe te grumbulloje ne nje vend te caktuar dhe nga germimet ne rruget me trase se te re. Eshte parashikuar te mbillen peme te tipit dhe shkure te ulta.

Ndricimi i shetitores.

Ndricimi i shetitores eshte parashikuar me led te ushqyer me rryme nga elemente fotovoltaik. Ne disa intersektimi jane parashikuar parashikuar shtyla me dy ndricues ndersa ne shetitore ndricuesit jane me tek llampe. Eshte zgjedhur ndricuesi led me ushqim fotovoltaik se nuk kerkon shpenzine per furnizimin e me rryme, nuk ka shume nevojë per mirembajtje se nuk ka rrjet dhe jetegjatesia e perdorimi te ndricuesit shkon deri ne 20 vjet. Ndricuesit kane automoni 3 ditore, qe do te thote edhe pse ne 72 ore nuk do te kete ushqim te baterise nga paneli fotovoltaik ndicuesi funksionon.

Shtyllat e ndricimit jane parashikuar te vendosen ne aks te brezit te gjelber anash rreuges nacionale , ato montohen ne nje bllok betony 40x60c 8c cm me nje pllake heuri apo me bolona te montuar ne bazamente. Bazamentet mun te behn esde parafabrikat duke u prodhuar ne ndonje fabrike apo poligon te certifikuar .

STUDIO PROJEKTUESE

IRGEN-SGT GROUP

